

UNIVERSITETI “NËNË TEREZA” NË SHKUP
FAKULTETI I SHKENCAVE SOCIALE
STUDIME TË CIKLIT TË DYTË - MASTER

DREJTIMI:

STUDIME EUROPIANE DHE MARRËDHËNIE NDËRKOMBËTARE



Tema:

**LËVIZJET E POPULLSISË SË KOMUNITETEVE ROMË, ASHKALINJ
DHE EGJIPTAS NË KOSOVË PARA DHE PAS VITIT 1999**

Mentori:

Doc. Dr. Fati Iseni

Studenti:

Besnik Rustemi

Shkup, 2021

Deklaratë

Unë Besnik Rustemi, deklaroj se gjatë përgatitjes së punimit të magistraturës, të gjitha fjalitë, frazat dhe idetë nga literatura e shfrytëzuar dhe të përdorura në këtë punim, nga autorë të tjerë, janë cituar në mënyrë korrekte, nëpërmjet referencave në stilin APA.

Jam i vetëdijshëm se përgjegjësia morale dhe ligjore është imja, si autor i punimit të temës së magistraturës. Në rast se gjatë këtij punimi, hasen fraza të kopjuara apo ngjitura, të literaturave të tjera, pa u cituar e drejta e autorit dhe nëse nuk është vepruar në përputhshmëri me normat metodologjike hulumtuese, atëherë punimi i magistraturës mund të konsiderohet plagjiaturë dhe do të përdoret si arsye, për dështim të këtij punimi master me temë: “Lëvizjet e popullsisë së komuniteteve Romë, Ashkalinj dhe Egjiptas në Kosovë para dhe pas vitit 1999”.

Kandidati:
Besnik Rustemi



Nënshkrimi _____

Shkup, 2021

Dedikuar vajzave të mija Perlës, Kjomës, Emarës dhe bashkëshortes time Albulenës

Abstrakt

Gjatë hulumtimit të temës do të fokusohem në disa qëllime(çështje) të cilat në fund të studimit do të paraqesin një pasqyrë të dhënash, faktesh dhe ngjarjesh që do të mund të realizonin më së miri qëllimin e këtij studimi. Analizimi i strukturës së popullësisë Rome, Ashkalinj dhe Egjiptiane që jetojnë apo jetuan në Kosovë, shkaqet socio ekonomike dhe detajeve tjera të cilat ndikuan në lëvizjen e brendshme apo të jashtme të tyre para dhe pas vitit 1999, janë dy qëllime kryesore të këtij studimi.

Zbërthimi i termit RAE (Romë, Ashkalinj, Egjiptian), ngjajshmëritë dhe dallimet mes tyre po ashtu janë elemente që do të trajtohen me kujdes dhe respekt.

Integrimi në arsim, jetën kulturore, institucionale dhe përfaqësimi politik i këtyre komuniteteve është interes i veçantë që gjithashtu do të trajtohen përgjatë punimit.

Në përmbledhjen e fundit, studimi synon të ofrojë fakte historike që kanë ndodhur apo që vazhdojnë të ndodhin edhe sot, si dhe gjithashtu do të ofrohen krahasime mes viteve, grupeve minoritare apo edhe karakteristikave të tjera socio kulturore në Republikën e Kosovës.

Fjalët kyçe: Personat e kthyer, Komunitetet Romë, Ashkali dhe Egjiptian

Абстракт

Од истражувањето на темата ќе се фокусирам на некои цели кои на крајот на студијата ќе дадат преглед на податоци, факти и настани кои најдобро би можеле да ја реализираат целта на оваа студија. Главната цел на оваа студија е да се анализира структурата на ромското, ашкалиското и египетското население што живеат или живеат во Косово, социо-економските причини и други детали што влијаеле врз нивното внатрешно или надворешно движење пред и по 1999 година.

Распаѓањето на терминот РАЕ (Роми, Ашкали, Египќани), сличностите и разликите меѓу нив се исто така елементи на кои ќе се постапува внимателно и со почит.

Интеграцијата во образованието, културниот, институционалниот живот и политичката застапеност е посебен интерес посветен на оваа теза.

Студијата на крајот ќе има за цел да обезбеди историски факти што се случиле тогаш или дури и она што се случува денес, и ќе има за цел да направи споредби помеѓу години, малцински групи или други социо-културни карактеристики во Република Косово.

Клучни зборови: Повратници, Ромска заедница, Ашкали, Египќани

Abstract

The research topic is focused in few goals which at the end of the study are reflected in a range of data, facts and events that would accomplish at the best level possible the goal of this study. Analyzing the structure of Roma, Ashkali and Egyptian population living or that have lived in Kosovo is the main purpose of this study as well as socio-economic consequences and other details that have affected their internal or external movement before and after 1999.

Elaborating the term RAE (Roma, Ashkali, Egyptian), similarities and differences between these population groups are aspects that will be treated with care and respect.

Integration in education, cultural and institutional life as well as political representation are of specific interest to be addressed in this thesis.

The study at the end aims to provide historical facts that have happened in the past or that are happening today; it aims to compare data between years, minority groups and other socio-cultural characteristics in the Republic of Kosovo.

Keywords: Returnees, Roma Ashkali Egyptian Communities

PËRMBAJTJA

Deklaratë.....	1
Dedikimi.....	2
Abstrak	3
Абстракт	4
Abstract	5
HYRJE	8
QASJE METODOLOGJIKE E HULUMTIMIT.....	9
Rëndësia e hulumtimit.....	9-11
Rëndësia e problemit dhe arsyet që kanë frymëzuar në zgjedhjen e temës	11-12
Qëllimi i hulumtimit, qëllimet specifike dhe arsyetimi shkencor i hulumtimit.....	12-13
Hipoteza.....	13-14
Mënyra e hulumtimit dhe metodologjia.....	14
Dizajni i studimit (korniza kohore e hulumtimit).....	15
Pjesmarrësit në hulumtim ose karakteristikat dhe parametrat kryesore të kampionit që do të përdoret në hulumtim.....	15
Vendi ku do të bëhet hulumtimi.....	15
Etika e hulumtimit	15
Procedurat e grumbullimit të të dhënave (instrumentet matëse)	15

Analiza e të dhënave (përpunimi statistikor).....	16
Rezultatet e pritura.....	16
KAPITULLI I KOSOVA PARA VITIT 1999.....	17
1.1. Çështja e Kosovës nën Jugosllavi dhe ngjarjet kryesore në vitet e 90-ta.....	17-22
1.2. Lëvizjet demografike në Kosovë nga viti 1948 deri në vitin 2011.....	22-25
1.3. Komunitete apo Minoritete.....	25
1.4. Përkufizimi i minoriteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian.....	26-28
1.5. Intelektualët serb karashi çështjes së Kosovës.....	28-29
KAPITULLI II KOSOVA PAS VITIT 1999.....	30
2.1. Pasqyrë e situatës socio politike pas qershorit të vitit 1999 dhe roli i UNMIK-ut.....	30-31
2.2. Integrimi i komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian dhe pjesëmarrja në jetën socio politike pas vitit 1999.....	31
2.3. Përfaqësimi politik dhe roli i komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Shpalljen e Pavarsisë së Kosovës.....	32-34
2.4. Pjesëmarrja në arsim, kulturë dhe organizatat e shoqërisë civile.....	34-37
KAPITULLI III HULUMTIMI EMPIRIK.....	38
Rezultatet	
3.1. Situata në Kosovë para vitit 1999 dhe terminologjitë.....	38-39
3.2. Situatat në Kosovë pas vitit 1999 dhe sfidat e integrimit social.....	39-41
3.3. Sfidat, vështirësitë dhe përfitimet e të qenurit Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Republikën e Kosovës.....	41-46
3.4. Çka ofron Republika e Kosovës për këto grupe minoritare dhe pritshmëritë e tyre.....	46-47
KONKLUZIONE.....	48-50
REKOMANDIME.....	51-52
Referencat.....	53-61

Hyrja

Duke pasur parasysh që konfliktet vazhdimisht kanë prodhuar lëvizje të popullësisë qoft brenda vendit, të njohur sipas përshkrimit të Zyrës së Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatët UNHCR-së si “Personat e zhvendosur brenda vendit” apo PZHBV, është dikush që detyrohet të largohet nga shtëpia e tij, por kurrë nuk ka dalë nga kufiri kombëtar. Gjithashtu po nga ky organizëm kemi edhe përshkrimin e statusit të refugjatit e cila përkufizohet si “individ që është detyruar të largohet nga vendi i tij ose i saj për shkak të persekutimit, luftës ose dhunës”. Pra refugjati ka frikë të bazuar në përndjekje për arsye race, feje, kombësie, mendimi politik ose anëtarësimi në një grup të veçantë shoqëror. Gjithashtu lufta dhe dhuna etnike, fisnore dhe fetare janë shkaqet që refugjatët largohen nga vendet e tyre.

Po ashtu edhe definicioni i tretë i cili lidhet me Pashtetësinë përkufizohet si “një person pa shtetësi është dikush që nuk është qytetar i asnjë vendi”, pra bazuar në atë që në praktikë “shtetësia” është lidhja ligjore midis një shteti dhe një individi, e cila garanton disa të drejta si politike, ekonomike, sociale (UNHCR, 2001).

Pra këto tri kategori që u cekën më lart janë interes i kësaj teme për t’u hulumtuar, veq se kjo do të bëhet në kontestin e Kosovës dhe persoave të cilët dikur kanë jetuar në këtë territor mirëpo sot nuk jetojnë. Përsa i përket Romëve, të cilët në Kosovë njihen dhe me termin RAE i cili ngërthen në vete edhe dy komunitete ashkalinj dhe egjiptas, ku këtë dallim do t’a bëjmë më poshtë megjithatë si karakteristikë e tyre është edhe flamuri i aprovuar nga Komiteti Ndërkombëtar i Romëve në vitin 1971 i cili veç të tjerash e paraqet edhe rrotën e cila simbolizon lëvizjen e vazhdueshme dhe përparimin. Ndërsa dhe Ashkalinjët dhe Egjiptianët në Kosovë e kanë flamurin e tyre secili.

E gjithë kjo filozofi me rrotën tek romët saktësisht me lëvizjen e ka një karakteristik në vete e cila edhe sot i përfytyron më së miri anëtarët e bashkësisë Rome të cilët lëvizin shpesh nëpër vendet dhe rajone të ndryshme, më shumë si PZHBV (Persona të zhvendosur brenda vendit) por edhe si refugjatë.

QASJE METODOLOGJIKE E HULUMTIMIT

1. Rëndësia e hulumtimit

Në Kosovë përveç Shqiptarëve shumicë, jetojnë dhe rreth 10% komunitet si serb, turq, goran, boshnjak, romë etj, për këtë edhe flamuri i Kosovës i ka 6 yje (worldatlas, 2020). Mirëpo kemi edhe komunitete tjera si kroat e malazez, këta të fundit disa herë kanë bërë kërkesë që në flamur të vendoset edhe një yll për t'a (Malësia, 2013).

Kur themi komuniteti "Romë" në praktikë shpesh mendohet edhe për ashkalinjë e egjiptjan. Mirëpo sipas (Arifi, 2009) para vitit 1999 komunitetet ashkalinj dhe egjiptjan u njohën më shumë si shqiptarë pasi që feja dhe gjuha ishte e njejtë. Kurse komuniteti romë kishte gjuhën e vet, gjuhën rome. Mungesa e informatave të mjaftueshme për komunitetet ka bërë që as ata vet të mos e njohin këtë dallim.

Sipas deklaratës së dhënë në një takim me shoqërinë civile në muajin dhjetor 2019, organizuar nga organizata Advancing Together, Deputeti i Komunitetit Romë z.Albert Kinolli deklaroi që *"para luftës në Prishtinë jetonin rreth 50 mijë romë, kurse tani nuk jetojnë as 100"*.

Bazuar në atë që u tha më lart dhe në parimet universale të të drejtave të njeriut, veç të tjerash edhe Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut nënvizon se "Të gjithë kanë të drejtë për një kombësi" mund të themi që këto komunitete janë populli i vetëm në botë që nuk kanë shtet administrativ i cili do t'i mbronte interesat dhe të drejtat e tyre legjitime.

Kjo është edhe arsyeja kryesore se pse e kam marrë për t'a studiuar këtë temë, e cila mund të jetë sfiduese për shumë arsye, duke filluar edhe nga konteksti social e kulturor. Nga praktika ditore mësojmë që vet zyrtarët e institucioneve në rastet kur kemi martesë të hershme, braktisje shkolle apo dhunë në familje ata thonë që "këta janë kështu", pra dmth "ne nuk kemi çfarë të bëjmë më shumë", pra si institucionet nuk interesohen me tepër edhe pse e kanë obligative dhe obligim ligjor.

Arsye tjetër specifike është që ka disa vite që jam i angazhuar në një projekt në kuadër të Qendrës Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës, mbështetur nga UNHCR-ja. Aty bëj detyrën e Punonjësit Social dhe çdo ditë jemi në kontakt me këto familje dhe sfidat e tyre.

Publikimi “Diplomacia Rome”(Nivolae & Slavik, 2007, fq.39) Thekson veç tjerash që për dallim nga vendet e tjera të ballkanit, romët e Kosovës ishin të shkolluar, kishin një elitë udhëheqëse dhe ishin mirë të integruar në shoqëri. Një pjesë e tyre anonte nga autoritetet, populli serb, kurse pjesa tjetër nga shumica shqipëtare (e cila ndodhej nën pushtetin serb). Sipas tyre ishte gabim mos përfshirja e romëve në bisedimet për përfundimin e luftës në Rambuje, dhe më pas shumica e tyre u larguan pas vitit 1999 së bashku me forcat jugosllave. Ata besojnë që romët u gjendën në një situatë të vështirë kur para vitit 1999 serbët i akuzonin për bashkëpunim me shqiptarët dhe pas konfliktit të vitit 1999 ndodhi e kundërta.

Vlerësohet gjithashtu se para konfliktit në Kosovë jetonin më shumë romë se sa sot dhe rreth 80% u larguan pas vitit 1999 dhe shtëpitë e tyre u shkatrruan. Nga konfliktet jugosllave në vitin 2000 llogaritej që rreth 50 mijë romë ishin zhvendosur kudo në ballkan dhe rreth 60 mijë ishin refugjat në vendet e Bashkimit Europian (Nivolae & Slavik, 2007, fq.40).

Lëvizjet e popullsisë janë normale kudo në botë, mirëpo ato janë të diktueshme dhe të dyshimta kur kemi të bëjmë me forma të organizuara apo pa organizuara, por që të cilat marrin pas vetes shumë persona. Edhe sot 20 vite pas luftës në Kosovë kemi banorë të cilët janë refugjat në vendet si Gjermani, Itali, Francë, Suedi apo kudo në Bashkimit Evropian (Preportr, 2012).

Sipas Strategjisë për komunitete dhe kthim 2009 - 2013 rreth 20,000 persona nga komunitetet pakicë janë kthyer në Kosovë deri në vitin 2006.

Në vitet kur ish Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë kishte një lulëzim ekonomik, kulturorë e mbi të gjitha social, popujt e vegjël dhe minoritetet kombëtare i gëzonin të gjitha të drejtat e garantuara me konventat e deklaratat universale.

Mirëpo në vitet e 80-ta kur udhëheqësi Josip Broz Tito vdiq, në piedestalin e motos “vllaznim dhe bashkim” filluan të lulëzojnë nacionalizmat e republikave specifike. Kështu serbët filluan me

heqjen e Autonomisë së Krahinës së Kosovës në vitin 1989 dhe me pas filluan edhe konfliktet e armatosura në Slloveni (1991), Kroaci (1991-95), Bosnje dhe Hercegovinë (1992-95) e Kosovë (1998-99).

Të gjitha këto elemene përcaktuan më vonë edhe fatin e miliona njerzve brenda këtyre kufinjëve. Në teritorin e Kosovës përveç shqiptarëve shumicë (mbi 90%) dhe serbëve rreth 7%, pjesën tjetër e përbënin boshnjakët, turqit, romët, ashkalinjt dhe egjiptianët.

Bazuar në të dhënat e fundit demografike tani në Kosovë jetojnë më pak se 7% anëtar të këtyre komuniteteve, e prej tyre më pak se 1% janë RAE (Central Intelligence Agency, 2020).

2. Rëndësia e problemit dhe arsyet që kanë ndikuar në zgjedhjen e temës!

Shpesh herë kur kemi qenë fëmijë e kemi dëgjuar nga të rriturit termat përbuzëse “magjup”, “gabel” apo edhe terma të tjera të ngjajshme. Vazhdimisht këto emërtime e kanë provokuar shoqërinë dhe në dekadën e fundit kur në terminologji janë futur emërtimet zyrtare si ashkalinj apo romë, prap kemi raste kur epitetet e lartpërmendura përdoren pa hezitim, kjo është hasur edhe në nivelin publik qeveritar (Insajderi.com, 2017).

Unë për një kohë të gjatë, më se 10 vite kam vepruar në sektorin e shoqërisë civile me projekte të ndryshme, kurse tani punoj në një projekt i cili mbështetër nga UNHCR- zyrja në Kosovë dhe i cili ka për qëllim ofrimin e ndihmës psiko sociale për personat me interes, në fokus grupin e agjencisë. Duke parë punën dhe aktivitet që bëjmë në teren me ka lindur ideja që të merrem me këtë temë, për të cilën mendoj që deri më tani nuk është bërë ndonjë hulumtim i veçant rreth kësaj kategorie. Unë kam vendosur që të sfidoj disa mendime kolektive (shpesh herë stigmatizuese) të cilat e përcjellin shoqërinë kosovare thujse qe 20 vite e mos më shumë. Duke pasur parasysh këta faktorë, me anë të këtij punimi unë dëshiroj të shikoj dhe hulumtoj se cilat janë: **Lëvizjet e popullësisë së komuniteteve Romë, Ashkalinj dhe Egjiptas në Kosovë para dhe pas vitit 1999, shkaqet, struktura dhe veçoritë e tjera.**

Unë jam i vetëdijshëm për punën e lodhshme që do të kem në punimin e temës në fjalë, andaj bashkpunimi im me mentorin tim është i domosdoshëm. E mirëpres çdo ndihmë, sygjerim apo këshillë, qoftë në lidhje me gjetjen apo shqyrtimin e literaturës dhe qështjeve tjera që do të na hyjnë në punë për këtë punim.

3. Qëllimi i hulumtimit, qëllimet specifike dhe arsyetimi shkencor i hulumtimit

Ky hulumtimi ka për qëllim analizimin e strukturës së popullësisë, shkaqeve socio ekonomike dhe detajeve tjera të cilat ndikuan në levizjen e brendshme apo jashtme të qytetarëve nga komunitetet romë, ashkalinjë dhe egjiptas të cilët jetonin në Kosovë para dhe pas vitit 1999. Si qëllime specifike janë marrë tri elemente, të cilat do t'a kanalizojnë realizimin e qëllimit të hulumtimit:

Statusi civil , shoqëror e ekonomik i këtyre qytetarëve sot. Shumica e atyre që janë zhvendosur në vendet e rajonit si Serbia, Maqedonia Veriore dhe Mali i zi nuk posedojnë dokumentacion civil të asnjërit nga këto shtete e as të Republikës së Kosovës. Kjo krijon vështirësi praktike ekzistenciale sepse ata nuk mund të gëzojnë asnjë ndihmë institucionale, vetëm regjistrohen në statistika. Këta persona hyjnë në kategorinë e UNHCR-së si ‘njerëz pa shtetësi’ (UNHCR, 2001).

Procesi i kthimit dhe ri integritet. Të kthyerit janë gjithashtu në grupin e personave me interes për UNHCR-në dhe institucionet e Kosovës. Në Kosovë ata janë kthyer në përgjithësi nga vendet e rajonit, por edhe nga vendet e Bashkimit Europian në formë vullnetare. Procesi i kthimit ka qenë i vështirë si për nga mungesa e dokumenteve personale ashtu dhe mungesa e pronave, megjithatë atyre u janë ndërtuar shtëpi nga fondet e BE-së dhe ato qeveritare nëpër zona/prona të caktuara kolektive apo dhe në prona private. Gjithashtu u është garantuar mbështetje në edukim, trajnime profesionale, stimulim në vetëpunësim dhe edukim plotësues (Kallxo.com, 2019). Megjithatë riintegrimi i personave të kthyer nuk ka dhënë efekt afatgjatë sepse shumica prej tyre përsëri janë zhvendosur në vendet nga janë kthyer apo në lokacione të reja. Ata i kanë shitur shtëpitë dhe nuk

kanë mundur të integrohen në sistemin edukativo arsimor. Këtu gjithashtu kanë ndikuar kryesisht faktorët ekonomik, sepse përshembull në Kosovë një meditje pune për punë të thjeshta paguhet nga 10 në 15 Euro kurse në Mal të Zi nga 25 në 30 Euro.

Shteti si mekanizëm, e getoizimit dhe politika. Duke kujtuar politikat e getoizimit të nazistëve në Poloni 1939–41 (Browning, 2008) mund të tërheqim paralele të ‘‘getoizimit modern’’ në dekadat e fundit i cili i’u është bërë personave të zhvendosur dhe atyre me statusin e refugjatit, sipas fokus grupit të UNHCR-së. Specifikisht, personat e zhvendosur jashtë Kosovës në vijë ajrore nga kryeqyteti Prishtina ndodhen rreth 100 km por që nga viti 1999 ata nuk kanë mundur të kthehen në shtëpitë, pronat e tyre, kjo edhe për faktorët politik. Serbia nuk i pajis me dokumentacion por as nuk lejon që Kosova t’a bëjë dhe ata kanë mbetur të izoluar. Veç tjerash edhe personat e kthyer janë sistemuar nëpër zona periferike të qyteteve, shembull lagjja ‘‘Koloni’’ në Gjakovë, e cila është ndërtuar me shtëpi për të kthyerit buzë deponisë së mbeturinave të qytetit. Po ashtu ndërtesat kolektive dhe shtëpitë në fshatin Plemetin, rreth 5 km nga qyteza e Obiliq-it që ndodhen buzë Termocentralit Kosova B, pra njëherësh ndotësi kryesor i ajrit. Gjithashtu edhe vetë zona është e pa zhvilluar, qoftë për bujqësi apo jetë kolektive sociale, duke qenë një zonë industriale.

4. Hipoteza

Bazuar në të dhënat nga tereni, kemi dy hipoteza kryesore:

H1 - Personat e larguar nga Kosova para dhe gjatë vitit 1999 janë larguar për arsye të ndryshimeve politiko-shoqërore dhe sigurisë të cilat ndodhën me largimin e autoriteteve Jugosllave dhe ardhjen e UNMIK-ut, e Institucioneve Vetëqeverisëse të cilat udhëhiqeshin nga Shqiptarët e Kosovës.

H2 - Personat e zhvendosur brenda vendit, kanë lëvizur për arsye ekonomike (jeta më e mirë) nga komunat e vogla në komuna më të mëdha (zhvilluara).

5. Mënyra e hulumtimit dhe metodologjia

Metodologjia e përdorur në këtë hulumtim është shqyrtim i literaturës, ku veçojmë dokumente zyrtare nga institucionet ndërkombëtare, ato të shtetit të Kosovës, raportet zyrtare nga organizatat ndërkombëtare dhe institucioneve përcjellëse ndërkombëtare. Publikime dhe postime të kohës nëpër gazeta, portale elektronike (ndërkombëtare dhe kombëtare) të ndodhive, situatave të cilat kanë ndikuar direkt/indirekt në kohezionin social të temës që po trajtojmë.

Mostra do të jetë e qëllimshme dhe do të realizohen:

- Katër intervista gjysmë të strukturuar – me zyrtarët komunal për komunitete.
- Dymbëdhjet intervista të strukturuar – me personat e kthyer/zhvendosur.

Struktura e pjesëmarrësve në intervista gjysmë të strukturuar:

Nr	Institucioni	Pozita	Persona
1	Zyrat Komunale për Komunitete	Zyrtar për Kthim dhe Komunitete	4

Struktura e pjesëmarrësve në intervista gjysmë të strukturuar:

Nr	Statusi	Pjesmarrja	Gjinia
1	Të kthyer nga jasht Kosova	6 Persona	F/M 50%
2	Të zhvendosur brenda Kosovës	6 Persona	F/M 50%

6. Dizajni i studimit (korniza kohore e hulumtimit)

Studimi është fokusuar që të realizohet në afat kohor prej 3 muajve. Periudha e intervistimit në teren padyshim që është më sfiduesja për shkak të territorit të madh që duhet përshkruar në

aspektin logjistik dhe situatën pandemike si dhe koha e pushimeve vjetore për disa nga zyrtarët komunal.

7. Pjesëmarrësit në hulumtim ose karakteristikat dhe parametrat kryesore të kampionit që do të përdoret në hulumtim

Studimi ka pjesëmarrës gjithësej 16 persona, ku varësisht prej funksionit të tyre secili ka për të dhënë diçka të dobishme dhe më pas kur të gjitha nga pak do bëhen bashkë atëher do kemi një pasqyrë të qartë.

Zyrtarët komunal janë personat të cilët mirren me këtë punë qe 20 vite dhe kanë ndjekur shumë procese të kohës, si trajnime apo aktivitete të kthimit të këtyre personave. Kurse vet personat e kthyer apo zhvendosur janë ata të cilët i kanë përjetuar vet këto procese për më shumë se 25 vite.

8. Vendi ku do të bëhet hulumtimi

Hulumtimi u realizua brenda territorit të Kosovës në lokacionet e përqëndruara nga këto komunitete, në komunat si Peja, Gjakova, Ferizaj, Klina, Shtërrpca dhe Shtimja.

Etika e hulumtimit

Hulumtimi është bazuar duke respektuar parimet etike të hulumtimit si dhe është marr aprovimi nga mentori i lëndës Doc.dr. Fati Iseni.

9. Procedurat e grumbullimit të të dhënave (instrumentet matëse)

Për këtë studim janë realizuar kryesisht intervista gjysmë të strukturuar – me zyrtarët komunal për komunitete, dhe intervista të strukturuar – me personat e kthyer/zhvendosur.

Intervistat përmbajnë 10 - 15 pyetje.

10. Analiza e të dhënave (përpunimi statistikor)

Intervistat me pjesëmarrës është transkriptuar dhe me pas u bë kodimi i fjalëve, dhe nga kodet e krijuara janë nxjerrur rezultatet.

11. Rezultatet e pritura

Nga ky hulumtimi presim që të kemi rezultate të qarta lidhur me lëvizjet e popullësisë së komuniteteve rom, ashkalinj dhe egjiptas në Kosovë të cilët janë zhvendur para dhe pas vitit 1999, brenda territorit të Kosovës, por edhe në vendet e rajonit si Serbia, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi dhe Serbia.

Të dhënat si: shkaqet, struktura dhe veçoritë e tjera të cilat kanë ndikuar në këto lëvizje kolektive.

Gjendja socio ekonomike dhe përciptimet e këtyre personave për të ardhmen do të jenë treguesit kryesorë të nevojave dhe sfidave me të cilat ata ballafaqohen sot.

KAPITULLI I

KOSOVA PARA VITIT 1999

1.1. Çështja e Kosovës nën Jugosllavi dhe ngjarjet kryesore në vitet e 90-ta

Sipas Baldwin (2006) pas Lidhjes së Prizrenit të vitit 1878 dhe kryengritjeve të vitit 1910 respektivisht 1912, tek shqiptarët filloi një riorganizim për liri dhe çlirim nga Perandoria Osmane. Pas mbarimit të luftërave ballkanike (1912-1913) Serbia ishte zgjeruar nga 48 mijë në rreth 87 mijë km katrorë dhe ishte rritur me popullësi nga rreth 3 milion në 4.5 milion, prej tyre 1.2 ishin të deklaruar si musliman por në fakt ishin shqiptarë. (Gruda, 2017)

Deri në mbarimin e luftës së dytë botërore Kosova u pushtua nga Serbia e Bullgari ndërsa më pas nga Italia e Gjermania. Pas vitit 1945 u krijua Republika Popullore Federative e Jugosllavisë që më pas u njoh dhe si Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë (1963).

Krahas këtyre zhvillimeve kishte filluar dhe kolonizimi i Kosovës (Osmani, 2010) me kolon serb dhe malazez, këta të fundit morrën shumë beneficione dhe ishin të shpërndarë në gjitha komunat e fshatërat diku me 5 e diku me 25 familje. Në vitin 1974 me miratimin e Kushtetutës së re Kosova u avancua si në rrafshin juridik ashtu dhe në atë socio ekonomik (Hyseni, 2008) veç të tjerash u themeluan dhe Gjykatat Kushtetuese, Supreme, Prokuroria dhe të tjera. Në fillim të viteve 80-ta pasuan demonstratat me parullat ‘‘Trepça punon, Beogradi ndërtohet’’ e ‘‘Kosova Republikë’’, dhe këto piknisje më pas pasuan me marrjen e masave të dhunshme, ku të gjitha institucionet qëndore u bartën nga Prishtina në Beograd dhe nëpër institucione e ndërmarrje punuese kishte filluar largimi i shqiptarëve nga puna.

Gjithashtu sipas (Osmani, 2010) në këtë kohë kolonët kishin filluar të largohen nga Kosova, duke i shitur shtëpitë dhe pasuritë e tyre, kjo arsyetohej me gjoja presionin e shqipëtarëve pas forcimit të

institucioneve që udhëhiqeshin nga t'a e që derivohej nga kushtetuta e re. Serbia gjithashtu argumentonte se deri në vitin 1980 nga Kosova ishin larguar rreth 57 mijë serbë e malazezë.

Pas përfundimit të luftës në kroaci, respektivisht deri në fund të vitit 1995 rreth 30 mijë kolon të rinjë serb dhe malazez ishin vendosur nëpër qyte e Kosovës, në objekte shoqërore, konvikte, shkolla e shtëpi (banesa të marrura nga shqiptarët në vitet e 80-ta). Në anën tjetër deri në vitin 1996 në europë azil kishin kërkuar 350 mijë shqiptarë. (Osmani, 2010, f.124-128)

Dokumente zyrtare, top sekret të shtetit të serbisë, vendime, raporte të kohës dhe që lidhen me ngjarjet e viteve 1989 deri më 1999, e të cilat janë përdorur më poshtë janë marrë nga SENSE - Qendra për drejtësi tranzicionale në publikimet me emrin "TNPJ: RASTI I KOSOVËS 1998-1999. Hetimet, rekonstruktimi dhe ndjekja penale e krimeve". Ku të gjitha këto materialet ishin përdorur në gjykimet para Gjykatës Ndërkombëtare Penale për ish Jugosllavinë.

Në vitin 1989 Kuvendi i Kosovës nën masa të larta sigurie dhe presione nga politika e Beogradit arriti të bëjë ndryshimet kushtetues të nevojshme që juridiksioni i Kosovës të mbetej nën Serbi. Në këtë kohë filluan dhe lëvizjet nacionaliste të politikës serbe dhe vjen në pah imazhi i Sllobodan Millosheviqit. Në Qershor, 1990 u nxorr dhe dekreti për përfundimin e punës së Kuvendit të Kosovës, neni 1 theksonte se "S.A.P. (*Socjalistička Autonomna Pokrajina, në shqip Krahina Socialiste Autonome*) Kosova rrezikon sovranitetin, integritetin territorial dhe rendin kushtetues të SR Serbisë", neni 2 theksonte se të drejtat dhe detyrat e Kuvendit të Kosovë i merr Kuvendi i Serbisë. Gjithashtu dhe deputetet, administrata dhe të gjitha institucionet vartëse do të liroheshin nga detyra dhe Kuvendi i Serbisë do të bënte emërimin e zyrtarëve të rinjë. (Gazette of the Socialist Republic of Serbia No. 33/90, 1990)

Bogdan Bogdanović intelektual serb në vitin 1991 në "Monitor" kishte deklaruar se "ushtria dhe policia e mbajnë një paqe, sa për sy e faqe, por askush nuk ofron program" edhe politikani

Dragan Jovanović kishte deklaruar se në Kosovë ishin vendosur teknologji që shkaktonin ndotje të mjedisit dhe i kishte theksuar termocetralet duke i përshkruar si “tmerruese”. (Admovere, 2021)

Në vitin 1987 Serbia inskenoi një ngjarje në kazermën "Branko Krsmanović" në Paraçin ku rekruti shqiptar Aziz Kelmendi sipas raportimeve të kohës vrau katër pjestar të Armatës Jugosllave dhe u plagosën disa të tjerë. Kjo ngjarje jo e rastësishme u përdor nga mediat e kohës si karrem për të nisur nxitje tek etnitetet e ndryshme sepse personat e vrarë dy boshnjak dhe nga një serb, slloven e kroat. (Mertus, 1999, fq 145).

Edhe në histori janë evidentuar raste kur media i ka dhënë hov një situate apo problematike e cila më pas ka pasuar me dhunë vrasje apo spastrim etnik, shembull media në Ruandë para gjenocidit të vitit 1994 i paraqiti dy grupet etnike Tutsi dhe Hutus (të moderuarit) si të veçuar apo të privilegjuar nga pjesa tjetër shumicë Hutu. (Al Jazeera English, 2015)

Bajram Kelmendi një avokat i dalluar në vitin 1988 kundërshtoi “rastin e paraqitit” si një inskenim për të prishur imazhin e shqiptarve të Kosovës (Mehmeti, 2019), media serbe e kohës kishte shkuar aq larg sa ishte thënë se vrasja kishte ndodhur deri sa ushtarët ishin në gjumë. Avokati Kelmendi në ankesën e tij kishte paraqitur shkeljet që janë bërë në këtë proces, dhe pse 7 shqiptar ishin denuar më pas si mbështetës të Aziz Kelmendi, ata së pari ishin detyruar të pranonin pjesëmarrjen në ngjarje pa qenë fare pjesëmarrës. Bajram Kelmendi u vra mes datave 25 dhe 26 mars 1999 së bashku me dy djemt Kastrioti dhe Kushtrimi. (Sakte.net, 2016)

Në vitet e 90-ta kur shqiptarët largoheshin masovikisht nga puna, në këto pozita u angazhuan banorët rom (Baldwin, 2006, f.9). Romët veç tjerash u përdorën apo obliguan nga pushteti serb deri në fund të luftës së vitit 1999, ndërsa dhe në raste të tjera ishin pjesëmarrës me vullnet të plotë.

Vendimi për “masat e veçanta” i marru në qërshor 1990 la shumë shqiptarë pa punë, shkollat u mbyllën dhe administrata punonte vetëm me ligjet dhe gjuhën serbe. (Official Gazette of the Socialist Republic of Serbia, 1990)

Sipas UNHCR-së (Human Rights Watch, 2001) në tri javët e para të bombardimeve të NATO-së (që filluan me 24 mars 1999) 525,787 refugjatë nga Kosova u larguan në vendet si Shqipëria, Maqedonia dhe Mali i zi. Deri në mbarimin e luftës ishin larguar 862,979 shqiptarë etnikë nga dhuna e qeverisë së serbisë.

Në këtë periudhë filluan të paraqiteshin dhe përfshirjet e para të pjestarëve të komuniteti romë në kuadër të mekanizmave të sigurisë të udhëhequra nga Beogradi si ushtria dhe policia. Kjo dëshmohet dhe në dëshminë për Tribunalin Ndërkombëtar për Krime Luftë në Ish-Jugosllavi e dhënë nga ish anëtari i brigadës 549-t e motorizuar e cila vepronte në rajonin e Prizrenit dhe kishte rreth 2 mijë ushtarë që mirreshin kryesisht me ruajtjen e kufirit. Në këtë grup bënte pjese dhe një person i njohur si serbi "Vlah" gypsyi cili kishte ardhur nga Austria, (ICT, 2007, fq 6)

Angazhimi i "ciganëve" (Maxhupi) në grupet paramilitare dhe militare mendohej se ndodhi për arsye të marrjes së beneficioneve prej tyre, por besohet se ata më shumë dhe u përdorën nga Serbët. Një dëshmitar nga Prishtina tha se me 18 prill rreth 15 burra u rrëmbyen nga një turmë prej rreth 4 mijë personave dhe me pas u vranë. Ata i morri një grup prej 5 militarësh serb e mes tyre ishte dhe një që e quanin "Cigan", ai etiketohej se mirrej dhe me dëbime, zhvatje, rrahje ose vrasje në muajt prill dhe maj. Në qytetin e Vitisë gjithashtu ishte një paramilitar që e quanin "Cigan", gjithashtu dhe me 27 mars kur ushtria serbe rrethuan fshatin Palaj (Obiliq) mes tyre kishin qenë dhe dy paramilitarë "ciganë". Në muajin mars u raportuan vjedhje dhe dëbime në qytetin e Gjakovës dhe Prishtinës, dëshmitarët panë që në grup me serbet kishte dhe “Ciganë”. (OSCE, 1999, fq 242)

Në një raport top sekret të Ministrisë së Brendshme të Serbisë që bart datën 25 maj 1999, vërtetohej se kishte aktivitet kriminale me dijeninë e zyrtarëve të MB-së ku vet anëtarët e saj lokal dhe civilët po kryenin vjedhje të mjeteve motorike, mallra dhe gjera të tjera me vlerë në Kosovë. (Ministry of the Interior of the Republic of Serbia, 1999)


Se spastrimi etnik i Kosovës nga Serbia kishte filluar, e Human Rights Watch e quajti “spastrimit prej identitetit” kjo argumentohet dhe me rastet kur refugjatëve të dëbuar për në Shqipëri, ju merrnin targat e veturave dhe kartat e identitetit, pra ishte menduar që rikthimi i tyre të pamundësohej në të ardhmen. (Human Rights Watch, 2001)

Pra kishte një plan që nëpërmet vrasjeve në grupe dhe forma të ndryshme, dëbimeve kolektive, dhunës e torturave të ndikonte psikologjikisht në vetëdijen e viktimave që ata të largohen nga vedet e tyre apo për arsyjet që u cekën dhe më lart të vështirësohej kthimi dhe jetesa në vendin e kimit. (Human Rights Watch, 2001)

Në vitin 2000 UNHCR-ja raporton nëpërmjet (Kosovo Atlas (Second Edition), 2000) dokumentacioneve të saj për strukturën e popullsisë në vitin 2000, përfshirë dhe komunitetin Romë, Ashkalinjë dhe Egjiptian, në zonat ku ata jetonin, këto të dhëna janë paraitur më poshtë.

Figura 1

Popullësia e Kosovës sipas etnive dhe zonave ku ata jetojnë në vitin 2000.




Shënim: Harta e marrë nga *Kosovo Atlas (Second Edition), 2000, fq 5.*

Po nga ky dokument është marrë dhe pasqyra e dëmeve para dhe pas vitit 1999, nga të dhënat e hartës shihet se me shumë se gjysma e shtëpive ishin shkatërruar 100%, pra duhej rindërtuar.

Figura 2

Pasqyrë dëmtimi i banesave të banimit, dhjetor 1998 deri më qershor 1999



Shënim: *Harta e marrë nga Kosovo Atlas (Second Edition), 2000, fq 6.*

1.2. Lëvizjet demografike në Kosovë nga viti 1948 deri në vitin 2011

Sipas publikimit me titull “Ndryshimet demografike të popullsisë së Kosovës në periudhën 1948-2006” nga Enti i Statistikës së Kosovës publikuar në vitin 2008 ku përfshihen të dhëna për etnicitetet më të mëdha në Kosovë shqiptarë, serbë, turqit dhe romët, për këta të fundit pa specifikuar por me gjasë kur është menduar “rom” përfshinë dhe Ashkalinjtë dhe Egjiptianët sepse dhe në të dhënat e viteve 50, 60 apo 70 janë njohur me këtë term të trija këto komunitete. Në vitin 1981 ishte bërë regjistrimi i fundit nga Enti Federativ i Statistikave kurse regjistrimin e vitit 1991 shqipëtarët e bojkotuan kjo për arsye të situatës politike të rënduar por dhe për faktin se 128 punëtorë shqiptarë ishin larguar nga puna në mesin e viti 1990.

Të dhënat e paraqitura në tabelën e mëposhtme janë marrë nga publikimet e regjistrimeve për vitet 1948, 1953, 1961, 1971, 1981, në vitin 1991 nga EFS. Kurse për vitin 2006 ishte vetëm vlerësim i ESK-së. Nga regjistri zyrtar i popullsisë i mbajtur në vitin 2011 Kosova kishte 1.780.021 banorë, prej tyre shqiptarë 91%, serb 3.4% dhe të tjerë 5.6%. (Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2017)

Tabela 1*Popullsia e Kosovës sipas përbërjes etnike- 1948-2011*

Viti	Gjithësej	Shqiptarë	Serbë	Turq	Rom	Të tjerë
1948	733.034	498.244	176.718	1.320	11.230	45.522
1953	815.908	524.562	189.869	34.590	11.904	54.983
1961	963.988	646.605	227.016	25.764	3.202	61.401
1971	1.243.693	916.168	228.264	12.244	14.593	72.424
1981	1.584.440	1.226.736	209.798	12.513	34.126	101.267
1991	1.956.196	1.596.072	194.190	10.445	45.745	109.744
2006	2.100.000	1.932.000	111.300	8.400	23.512	24.788
2011	1.780.021	91 %	3.5 %			

Shënim: Të dhënat e marra nga publikimi “Ndryshimet demografike të popullsisë së Kosovës në periudhën 1948-2006”, Enti i Statistikës së Kosovës, 2008.

Nga të dhënat tabelare shohim lëvizje të popullsisë në disa drejtime vetëm tek shqiptarët nga vitit 1948 deri në vitin 2011 kemi ngritje lineare, kurse tek serbet kemi ngritje nga viti 1948 deri në vitin 1981, kurse nga vitin 1991 e tutje kemi zvoglim të popullsisë. Tek Turqit kemi një ngritje enorme nga vitit 1948 (1,320) në vitin 1953 (34,590), kurse në regjistrin e vitit 1961 dhe 1971 në të dyja këto regjistrime bije për nga rreth 10 mijë banorë.

Romët dhe pse e pa specifikuar se a janë vetëm rom apo dhe dy komunitete e tjera që janë njohur para vitit 1999 në gjuhën jo të përshtatshme “magjup” apo “cigan”. Megjithatë tek kjo kategori në regjistrin e vitit 1948 dhe 1953 kishte rreth 12 mijë banorë, kurse në vitin 1961 bije në 3,202

dhe për t'u ngritur më pas në vitin 1971 në rreth 14 mijë banorë. Në regjistrat e vitit 1981 dhe 1991 ky komunitet rritet në 34,126 respektivisht 45,745 banorë. në vitin 2006 parashikohej se ishin rreth 23,512 banorë.

Tek të tjerët kemi një gritje graduale nga viti 1948 deri në vitin 1971 me rreth 73 mijë banorë, ndërsa në vitin 1981 dhe 1991 ky grup rrite për rreth 40 mijë banorë. Në vitin 2006 mendohej se ishte rreth 25 mijë banorë.

1.3. Komunitete apo Minoritete

Sipas Britannica (2021) Minoriteti është grup i veçuar në aspektet kulturore, etnike ose racore, i cili bashkëjeton në kuadër të grupit më të madh shoqëror, por kjo nuk vlen si në rastin e Afrikës së Jugut nën aparteid apo dhe në rastin e Kosovës së vitit 1989 e tutje kur me vendim të kuvendit të serbisë, respektivisht mekaizmave të sigurisë së serbisë u morren veprime me pasojë largimin nga puna në formë të organizuar, mbylljen e shkollave, kontrollimi i jetës sociale nëpërmjet orës policore e masave të tjera policore, kur sipa regjistrat të popullsisë së vitit 1981 në Kosovë nga 1.584.440 banorë prej tyre shqiptarë ishin 1.226.736, serb rreth 210 mijë dhe 150 mijë Turq, Rom, e të tjerë. (Enti i Statistikës së Kosovës, 2008)

Sipas përkufizimit të fjalës "komunitet", marrim përkthimin "*një grup njerëzish që jetojnë në të njëjtin vend ose që kanë një karakteristikë të veçantë të përbashkët*" (Oxford Languages, 2021)

Pakica kombëtare nënkuptojmë (Ivanov, 1998), një grup të vogël qytetarësh që i përkasin shtetit, por karakteristikat e tyre dallojnë nga shumica (aspektet etnike, gjuhësore ose fetare).

Në Kosovë ne zhargonin publik dhe jo publik më shumë njohim si "komunitet" kjo ndodh që është dhe prej ndikimi të administratës ndërkombëtare nga përkthimi i fjalës "communities" e cila në shqip do të ishte "bashkësitë". Në Shqipëri pakicat janë të njohura më shumë si "minoritete" (Komiteti Shtetëror i Minoriteteve, 2021) kurse kur themi për "komunitetin" më shumë nënkuptojmë komunitetin fetar (vaticannews.va, 2018), artistik, sportiv etj.

1.4. Përkufizimi i minoriteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian

Sipas (Neziraj, XH & Stollaj, F, 2011) Fjala “Cigani” më parë quheshin Romët kjo popullësi e ardhur nga India. Por dhe “Gabel” është e ngjajshme me endacak, ndërsa në fjalorin Serbokroatisht-Shqip haset termi “Romani”. Cituar veprën “Esnafet shqiptarë” nga Faik Konica thuhet se Ciganët ndahen në dy grupe “arixhinj” endacake apo gabele me origjinë nga India dhe “jevgjit” joshetitës (ma'gjypet) me origjinë nga Egjipti. Dhe si rrjedhojë jevgjitët u përshtatën më shumë në qytetarinë shqiptare kurse romët jetuan nëpër zona të caktuara si të pa strehë.

Në vitet e 90-ta u themeluan organizata Egjiptiane në Ohër dhe Prishtinë e që kishin për qëllim ruajtje e popullsisë nga asimilimi në Shqiptarë (Friedman, 2007). Në Prishtinë shoqata quhej “Shoqata e Egjiptianëve të Kosovës dhe Metohisë” dhe udhëhiqej nga Vesel Kadroli.

Shpesh degjojmë frazën “*sfidat e komunitetit Rom, Ashkali dhe Egjiptian*” ku romët, Ashkalinjët dhe Egjiptianët paraqiten si një tërësi (komunitet). Qysh moti këto dallime kishin filluar të dilnin në pah, kjo nganjëher me qëllim të politikës së Beogradit për t’a zvogluar numrin e shqiptarëve në Kosovë, në vitin 1990 Milosheviçi kishte thënë se Egjiptianët e përbëjnë gjysmën e popullsisë në Kosovë (Cortiades, 2013)

Sipas (Hada, 2015) Romët në europë dhe shqipëri paraqiten qysh në shekullin XIII e deri në shekullin XV, bazuar në krahasimet gjyhësore ka mendime që romët kanë ardhur nga India. Ndersa dhe për komunitetin Egjiptian janë dhënë shumë versione për prejardhjen e tijë, njëra ndër to është se kanë ardhur nga egjipti i lashtë në shekullin 4 e 5 p.e.s, ka hipoteza të tjera që kanë ardhur dhe nga Spanja apo dhe nga Greqi si pasardhës të skllevërve egjiptian në Greqi. Dhe India si në rastin e romëve është thekuar si mundësi nga studiusit e ndryshëm.

Sipas (Malcolm, 2011, fq 274-278) Serbia kishte filluar qysh në vitin 1880 serbizimin e minoriteteve në Kosovë, shembull vllëhët e fundit rreth 120 familje nga Prizreni ishin serbizuar në

vitin 1912 e tutje. Në vitin e largët 1890 kisha serbe gjithashtu kishte ndikuar që përnjëhertë serbizoheshin dhe mbi 2 mijë romë të Kosovës. Serbia kishte ushtruar dhunë dhe persekutime edhe ndaj romëve shqipfolës në periudha të ndryshme, e veçanërisht gjatë luftës së dytë botërore ku shumë romë vriteshin, në Kosovë ata ishin të lirë, megjithatë llogaritet që në atë kohë rreth 1 mijë rom janë vrarë në Kosovë.

Sipas Portalit Shetrorë të Republikës së Kosovës fjalën “Komunitete” e përkufizojmë si:

“grupe kombëtare, etnike, kulturore, gjuhësore apo fetare tradicionalisht të pranishme në Republikën e Kosovës të cilat nuk janë shumicë”, ku këto grupe njihen dhësi qytetar “serb, turk, boshnjak, rom, ashkali, egjiptian, goran dhe komunitete të tjera”.

Se Ashkanlitë qysh pas vitit 1999 filluan të diferencohen apo theksojnë elemente veçuese nga komuniteti Romë dhe Egjiptian, kjo haset dhe në zgjedhjet e vitit 2001 ku ata aplikuan me emrin e partisë “Partia Demokratike Ashkanli Shqiptare e Kosovës”. (KQZ, 2001)

Pra nisur dhe vet nga përshtatja emrit Ashkanli (KQZ, 2004) apo Ashkali (KQZ, 2010) nga vet përfaqëuesit e këtijë komuniteti që zgjidhen në Kuvendin e Kosovës mund të themi që cilido shembull të përdoret në këtë studim nuk përbënë shqetësim për këtë komunitet.

Sipas Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë MISIONI NË KOSOVË në raportin “Raport për vlerësimin e të drejtave të komuniteteve Botimi i katërt” (OSBE, 2015) thekson se këto tri komunitete në disa raste ishin trajtuar si një komunitet i vetëm, kjo u has në rastet kur ishte emëruar një përfaqësues për tri komunitetet në Këshillin Komunalë për Siguri në Bashkësi.

Tabela e diferencave për teritorin e Kosovës sipas studiusit Francez Marcel Courthiade (2000) kjo tabelë në publikimin origjinal ka 19 dallime, kurse më poshtë janë paraqitur vetëm 6 sosh.

Tabela 2*Diferencat në mes Ashkalive dhe Romëve sipas Marcel Courthiade*

Endonim	Ashkali	Rom
Origjina	Egjipti (?)	India (qyteti Kannauj)
Gjuha e shtëpisë	Shqipja	Rromani
Emri në Shqipen e Kosovës	magjup	Magjup
Emri në Shqip, e Dukagjinit	magjup	Gabel
Pozicioni gjatë konfliktit	më shumë pro	në favor të statukuese
Pjesmarje në UÇK	Po	Jo

Shënim: *Marrë nga publikimi ‘LES RRROMS, ASHKALIS ET GORANS DE DARDANIE'/KOSOVO’, ADMOVERE, (Courthiade, 2000).*

1.5. Intelektualët serb karashi çështjes së Kosovës

Sipas (Le Bon, 2012, fq 49) në librin ‘‘Psikologjia e popujve dhe e turmave’’ paraqiten argumente se ‘‘institucionet e popullit përbëjnë shprehjen e shpirtit të tij dhe se edhe po qe ai nuk e ka të vështirë të ndërrojë pamjen e tyre të jashtme, ai nuk mund të ndryshoj bazën e tyre’’.

Në vitin 1912-13 me pushtimin e Kosovës, intelektualët serb si Kosta Novaković, Dušan Popović, Dimitrije Tucović dhe shumë të tjerë reagues ndaj dhunës së pushtetit serb karshi civilëve shqiptar në Kosovë. Edhe në historinë e re të viteve 90-ta kur i gjithë aparati shtetror serb ishte mbi kokat e popullit të Kosovës ishin ata pak intelektual serb si Bogdan Bogdanović, Ilija Dukić, Ivan Durić, Mirko Kovač e të tjerë që në ato kushte reagues duke kundërshtuar veprimet e tilla. (Admovere, 2021)

Sipas (Admovere, 2021) në librin “Sërbia tjetër, Druga Srbija, The other Serbia” përgaditur nga Shkëlzen Gashi, veqohet dhe një fragment i vitit 1989 nga me titull “*Jam një sërb pak më ndryshe*”, Bogdanović paraqiti fenomenin e të qenurit shqiptar në atë kohë në Kosovë “*...ne ishim në një veturë me regjistrim të Mitrovicës së Kosovës. Gjithçka na bënë gjatë rrugës: i binin burisë, fshkëllonin, kërcënonin se do të na shtypnin me kamion...*”. Në vitin 1992 kishte paralajmruar një katastrofë kombëtare për popullin serb, duke thënë që “do jemi kombi me armiq dhe i urreyer në Europë”

KAPITULLI II

KOSOVA PAS VITIT 1999

“Ne, udhëheqësit e popullit tonë, të zgjedhur në mënyrë demokratike, nëpërmjet kësaj Deklarate shpallim Kosovën shtet të pavarur dhe sovran. Kjo shpallje pasqyron vullnetin e popullit tonë dhe është në pajtueshmëri të plotë me rekomandimet e të Dërguarit Special të Kombeve të Bashkuara, Martti Ahtisaari, dhe Propozimin e tij Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës.”

Deklarata e Pavarsisë së Kosovës - 17 shkurt 2008, Prishtinë

2.1. Pasqyrë e situatës socio politike pas qërshorit të vitit 1999 dhe roli i UNMIK-ut

Kosova e, dhe pas vitit 1999 pervec varfërisë dhe shkatrimeve që kishin ndodhur gjatë luftës, shumë njerëz kishin humbur dhe vendet e tyre të punës dhe ekonomia ishte në kolaps. Me hyrjen e NATO-së në Kosovë dhe ndrrimin e administratës qeverisëse serbët dhe romët filluantë larguan nga Kosova, në këtë periudhë ata nuk deklaruan se kishin ndonjë arsye specifike apo frikë të drejtëpërdrejtë. Më vonë largimet e romëve filluan të ndodhin siç theksohet dhe në raportet e organizatave ndërokmbytare për arsye që shqiptarët refugjatë kur u kthyen në shtëpitë e tyre ato tashmë ishin djegur dhe pasuritë e tjera ishin shkatërruar, e për këto krime shqiptarët i akuzonin dhe romët për pjesëmarrje në grupe kriminale me serb lokal. (Human Rights Watch, 1999)

Bazuar në rezoluten 1244 këshilli i sigurimit të kombeve të bashkuara themeloi administratën e përkohshme në Kosovë (UNMIK) e cila përbëhej nga 49 kombe kontributdhënëse. Qëllimi ishte asistimi i administratës së përkohshme civile në Kosovën.

UNMIK-u përbëhej nga katër “shtylla” apo departmente:

Shtylla 1 , përgjegjëse për policinë dhe administratën e drejtësisë,

Shtylla 2, përgjegjëse për administratën civile, te dyja të implementuara nga Kombet e Bashkuara;

Shtylla 3, demokratizimi dhe ndërtimi i institucioneve, është implementuar nga Organizata për

Siguri dhe Bashkëpunim në Europë (OSBE); dhe Shtylla

4, rekonstruimi dhe zhvillimi ekonomik, i implementuar nga Bashkësia Europiane (B.E.). (Human Rights Watch, 2004)

2.2. Integrimi i komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian dhe pjesëmarrja në jetën socio politike pas vitit 1999

Në vitin 2001 nëpërmjet (Rregullores NR. 2001/9 PËR KORNIZËN KUSHTETUESE TË VETËQEVERISJES SË PËRKOHSHME NË KOSOVË, 2001) e cila më pas u njoh si “KORNIZËN KUSHTETUESE PËR VETËQEVERISJE TË PËRKOHSHME “ u vunë themelet e para për themelimin e institucioneve legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore, të cilat pas zgjedhjeve të 17 nëntorit 2001 do të udhëhiqeshin nga Kosovarët. Neni apo Kreu 3 Të drejtat e njeriut pika (ë) garanton zbatimin e Kornizës së Konventës së Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Minoriteteve Kombëtare. Gjithashtu dhe për përfaqësimin politik në Kuvend përcaktohet se:

1. (b) Njëzet (20) prej 120 vendeve rezervohen për përfaqësim plotësues të komuniteteve joshqiptare të Kosovës si vijon:
2. (i) Dhjetë (10) vende iu ndahen partive, koalicioneve, nismave qytetare dhe kandidatëve të pavarur që kanë deklaruar vetë se përfaqësojnë komunitetin serb të Kosovës. Këto vende iu shpërndahen partive, koalicioneve, nismave qytetare dhe kandidatëve të tillë të pavarur në proporcion me numrin e votave të vlefshme që ata kanë marrë në zgjedhjet për Kuvend dhe
3. (ii) Dhjetë (10), vende iu ndahen komuniteteve të tjera si vijon: romëve, ashkalinjve dhe komunitetit egjiptian katër (4), komunitetit boshjak tre (3), komunitetit turk dy (2) dhe komunitetit goran një (1). Vendet për secilin komunitet iu ndahen partive, koalicioneve, nismave qytetare dhe kandidatëve të tillë të pavarur në proporcion me numrin e votave të vlefshme që ata marrin në zgjedhjet për Kuvend.

Pra qysh para themelimit të institucioneve komuniteteve në përgjithësi dhe në veçanti atyre romë, ashkali e egjiptian u janë garantuar 20, respektivisht 4 ulëse.

2.3. Përfaqësimi politik dhe roli i komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Shpalljen e Pavarsisë së Kosovës

Me mbarimin e luftës në vitin 1999 dhe vendosjes së administratës ndërkombëtare, pra UNMIK-ut (United Nations Mission in Kosovo), në nëntor të vitit 2001 u krijuan kushtet dhe u mbajten zgjedhjet e para nacionale për përfaqësim në Kuvendin e Kosovës.

Në këto zgjedhje nga partit e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian fitues dolën këto parti:

INICIATIVA E RE DEMOKRATIKE E KOSOVËS, me 2 përfaqësues,
PARTIA DEMOKRATIKE ASHKANLI SHQIPTARE E KOSOVËS, me 2 përfaqësues,
PARTIA ROME E BASHKUAR E KOSOVES, me 1 përfaqësues. (KQZ, 2001)

Në zgjedhjet e vitit 2004 ishin këto rezultate:

IRDK, me 2 përfaqësues, PDAK, me 1 përfaqësues dhe PREBK, me 1 përfaqësues,

Humbja e një mandati për këto zgjedhje tek Ashkalinjët është si rezultat (veçtjerash) i ndarjes së tyre në dy parti. (KQZ, 2004)

Në zgjedhjet e vitit 2007 ishin këto rezultate:

PDAK, me 3 përfaqësues, IRDK, me 1 përfaqësues, PREBK, me 1 përfaqësues. Kujtojmë që kjo legjislaturë ishte dhe ajo e Shpalljes së Pavarsisë me 17 Shkurt 2008 dhe deputet nënshkrues të deklaratës së Pavarsisë nga këto tri komunitete ishin Zylfi Merxha (PREBK), Sabit Rrahmani, Etem Arifi, Hafize Hajdini (PDAK) dhe Xhevdet Neziraj (IRDK)

Në zgjedhjet e vitit 2010, pra zgjedhjet e para pas Pavarsisë, ishin këto rezultate:

Partia e Ashkalinjve për Integrim, me 1 përfaqësues, PREBK, me 1 përfaqësues, PDAK, me 1 përfaqësues, IRDK, me 1 përfaqësues, pra dhe në këto zgjedhje vërehen polarizimet, ndarjet mes liderëve dhe humbja e një mandati në Kuvend.

Në zgjedhjet e fundit nacionale për Kuvendin e Republikës së Kosovës mbajtur në vitin 2021 (KQZ. 2021) nga këto komunitet rezultati final ishte IRDK, me 1 përfaqësues, Partia e Ashkalinjve për Integrim, me 1 përfaqësues, Lëvizja Përparimtare e Romëve të Kosovës - LPRK (subjekt i ri), me 1 përfaqësues dhe Romani Iniciyativa (subjekt i ri), me 1 përfaqësues. Për dallim nga zgjedhjet e kaluara në këtë proces për herë të parë nga 4 ulëset e rezervuara për këto komunitete 2 nga ato i marrin partitë rome.

Në këto zgjedhje gjithashtu është konfirmuar një dukuri e themelimit të partive të reja, kjo jo nga vullneti i qytetarëve por me ndikime politike, etnike apo strategjike Duda Balje deputete e komunitetit boshnjak paralajmori se *“Me 10 mijë vota ata munden me i marrë prej 4 deri në 7 ulëse të deputetëve shtesë”* (Kallxo.com, 2021) duke aloduar se Lista Serbe po synonte që nga 10 vendet e rezervuar për komunitetet Turq. Boshnjak, Romë, Ashkalinjë dhe Egjiptian me krijimin e partive të reja apo mbështetjen e partive specifike brenda një komuniteti siç pretendohet për Koalicionin boshnjak VAKAT (Telegrafi.com, 2021) të kishte nën kontrollë dhe deputet shtesë përveç 10 vendet e saj që i ka të garantuara si komunitet serb.

Kjo hipotez e hedhur para parazgjedhjeve (Kosovapress, 2021) e njejta u konfirmua vetëm pas rezultateve finale dhe u vërtetua më vonë me vendimet e Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia. Me këto vendime u anuluan rezultate në disa komuna për partitë Rome dhe Boshnjake dhe si rezultat i këtyre partia Romani Iniciyativa që kishte marrë 4049 vota ra në 3.172 dhe humbi një mandat nga dy sa kishte (për t’u marrë Lëvizja Përparimtare e Romëve të Kosovës - LPRK), në rastin e partive rome kjo parti kishte marrë vota kryesisht në zonat e banuara me serb shembull në një rast në Kamenicë partia rome morri 44 vota ndërsa lista serbe 98, ndërsa në zgjedhjet e vitit 2019 vet lista serbe në atë vendvotim kishte 168 vota. Dhe në rastin e partive boshnjake Ujedinjena Zajednica – Adrijana Hodzic - UZ-AH që kishte marrë 6379 vota kryesisht në zonat e banuara me serb (kishte raste kur nuk kishte as dhe një boshnjak) por e cila ra në 2217 vota pas vendimit të panelit dhe e humbi mandatin e saj për t’i kaluar partisë tjetër boshnjake

Socijaldemokratska Unija- SDU, sipas panelit votat e partive boshnjake ishin rritur për 49% apo rreth 7 mijë sosh. (PZAP, 2021)

Pas rezultateve finale partitë Romë, Ashkali dhe Egjiptian morrën disa pozita kyçe në qeveri dhe për herë të parë një përfaqësues nga këto komunitet u bë ministër. (Kryeministri.rks-gov.ne, 2021)

Në qeverisjen lokale disa komuna si Ferizaj, Lipjani e Fushë Kosova kanë emëruar dhe nën kryetarin e komunës që vie nga këto komunitete. (Admovere, 2021)

2.4. Pjesëmarrja në arsim, kulturë dhe Organizatat e shoqërisë civile

Sipas (Silverman, 2012) në librin ‘‘Rrugët Romane: Politika Kulturore dhe Muzika Ballkanike në Diasporë’’ në Bullgarinë socialiste ishte e ndaluar muzika rome, ndërsa ishte lejuar një zhanër romë - ballkanik. Megjithatë ajo (rome) nuk mund të ndalej në ahengje familjare, ku dhe u vetë-zhvillua. Një gjë e tillë në Kosovë ka qenë gjithmonë e lejuar, para dhe pas vitit 1999.

Në Kosovë këto tri grupe minoritare janë të integruar në sistemin edukativo arsimor publik, por jo mjaftueshëm që të themi se zhvillohet mendimi kritik, dalin profesionistë të rinjë dhe kemi specialsit të fushave në masë. Megjithatë në kulturë, e specifikisht në muzikë instrumentistë e solistë të njohur që dëgjoheh e pëlqehen nga publiku i gjerë.

Maestro Karaçi, Memoria e Kosovës është përshkrimi që (Kamberi, 2019, fq.45) ka vënë për muzikantin rom Rexhep Karaçi i cili me instrumentin e tijë luajti në shumë skena dhe u përkrah, degjua nga publiku i kohës, por jo vetëm kaq.

‘‘Më trajtoni si një vëlla i vogël’’ ishte thirrja e shkrimtarit, politikanit Kujtim Paçaku gjatë një programi televiziv për zgjedhjet e vitit 2017, Paçaku një intelektual rom pas vdekjes la pas vetes shumë poezi e letra të shkruara letrare.(Kallxo.com, 2017)

Ashkalinjët dhe Egjiptasit janë të integruar në sistemin publik të arsimit fillor dhe të mesëm të Republikës së Kosovës, faktorët si zotrimi i gjuhës shqipe nga këto dy komunitete dhe afërsia

sociale me shqiptarët shumicë ndikon që ky integrim të jetë më i pranueshëm se në rastin e romëve të cilët shkojnë dhe në shkolla publike dhe në ato paralele të menaxhuara nga Serbia (Obiliq, Fushë Kosovë dhe Mitrovicë veriore). Gjendja e vështirë socio-ekonomike dhe rëndësia e vogël që i japin edukimit ndikon që këta nxënës t'a braktisin shkollën pa mbaruar klasën e 5-të apo 9-të. (ZÇK, 2021)

Sipas raportit "Sfidat e komunitetit Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë gjatë Pandemisë Covid - 19" (ADMOVERE, 2020) shkollimi fillor dhe i mesëm ka qenë sfidë para Shpalljes së Pavarësisë, mos përfshirja dhe diskriminimi kanë qenë me të theksuara. Pas vitit 2008 me ndihmën e organizatave të shoqërisë civile ka filluar që të ketë rritje të pjesëmarrjes nëpër shkolla fillore dhe të mesme nga nxënësit e komuniteteve romë, ashkalinj dhe egjiptianë.

Sipas Udhëzimit Administrativ 09/2016, *'aplikimi i masave afirmative dhe vendeve të rezervuara për regjistrim të kandidatëve nga komunitetet jo-shumicë në institucionet publike të Arsimit të Lartë'* përcaktohet se 12% e studenteve nga numri i përgjithshëm duhet të jenë nga komunitete pakicë në Kosovë (Serb, Boshnjak, Turk, Kroat, Romë, Ashkali, Egjiptian etj) gjithashtu në këtë përqindje është e rezervuar dhe strehimi në konvikte dhe ushqimi në menzën e studentëve. (MASHT, 20216)

Sipas ADMOVERE (2020) në hulumtimin "Përfshirja e studentëve të komuniteteve jo-shumicë në Universitetin e Prishtinës", sfidat e studentëve nga këto pakica për përfshirje në arsimin e lartë universitar janë gjendja ekonomike e rëndë apo mosnjohja e gjuhës shqipe, ndërsa universiteti ka pasur gjithmonë (që nga 2004/2005) kuota të pranimit dhe lehtësime të tjera. Shembull nga viti 2008 deri më 2020 në Fakultetin e Edukimit ishin 295 vende të rezervuara, kurse janë pranuar vetëm 20% apo 59 studentë, e prej tyre 36 RAE. Dhe nga ky numër vetëm 14 ka diplomuar (1 RAE).

Tabela 3

Numri i studenteve Romë, Ashkali, Egjiptian të pranuar dhe diplomuar për vitet 2008 - 2020 në Universitetin publik të Prishtinës

Nr	Fakulteti	Vendet e rezervuara (për të gjitha komunitetet)	Të pranuar (vetëm RAE)	Të diplomuar (vetëm RAE)
1	Fakulteti i Arteve	155	3	5
2	Fakulteti i Bujqësisë	361	2	0
3	Fakulteti i Edukimit	295	36	1
4	Fakulteti i Edukimit Fizik dhe i Sportit	157	3	0
5	Fakulteti i Ekonomisë	1060	25	3
6	Fakulteti i Filologjisë	469	16	4
7	Fakulteti i Filozofisë	476	42	1
8	Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës	340	9	2
9	Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike	360	6	0
10	Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike	301	8	0
11	Fakulteti Juridik	591	36	2

12	Fakulteti i Mjekësisë	409	44	1
13	Fakulteti i Shkencave Matematiko-Natyrore	398	2	1
/	Në total	5372	232	20

Shënim: Marrë nga hulumtimi “Përfshirja e studentëve të komuniteteve jo-shumicë në Universitetin e Prishtinës”, ADMOVERE, 2020.

Bazuar në profilin e të diplomuarve nga komunitetet Romë, Ashkali dhe Egjiptian më së shumti profile kemi tek profilet arteve (5), filologjisë (4), ekonomike (3), Ndertimtari/Juridik (nga 2), Filozofik/Mjeksi/Matematikor (nga 1).

Organizatave të Shoqërisë civile që veprojnë, avokojnë për këto tri komunitete janë të shumta, kemi organizata me bazë lokale, por dhe ato nacionale. Zëri i Romëve, Ashkalive dhe Egjiptasve (që nga 2011) e cila ka për qëllim integrimin e komuniteteve RAE në shoqërië Kosovare. Balkan Sunfloëers Kosova (që nga 2007) kultura dhe arsimit janë dy nga fushat që vepron kjo organizatë, gjithashtu dhe vullnetarizmi, aktivizmin, e shkëmbimin rajonal dhe ndërkombëtar janë veprimtaritë në fokus.

Rrjeti i Organizatave të Grave Romë Ashkali dhe Egjiptase të Kosovës vepron që nga viti 2007 kjo organizatë ka për qëllim promovimin e të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë. (Ministria e Administratës Publike, 2016)

KAPITULLI III

HULUMTIMI EMPIRIK

Rezultatet

3.1. Situata në Kosovë para vitit 1999 dhe terminologjitë

Të gjithë të intervistuarit nga komunitetet Romë, Ashkali dhe Egjiptian kanë mendimin e ngajshëm se në kohën e Republikës Socialiste Federative e Jugosllavisë (1963-1992) ata jetonin në kushte shumë të mira ekonomike, punë kishte për të gjithë dhe nuk kishte dallime etnike apo vështirësi të tjera sociale, dhe në rastet kur për arsye të ndryshme familja nuk kishte të ardhura ata ndihmoheshin nga të afërmit e që në shumicën e rasteve ishin bashkëfshatarë apo banues të lagjes së njejtë F.B tregon se *“përpara shqiptarët na kanë dasht ma shumë edhe punë kur nuk kish, nana dalke në mahall dhe i dhashin ushqime”*.

Ndërsa në vitet e më vonshme kur situata politike filloj të ashpërsohet ndërmjet shqiptarëve dhe pushtetit serb, pra ishte koha e Republikës Federative të Jugosllavisë (1992-2003) dhe Serbia kishte marrë rol dominant në kuadër të “federatës”. Edhe për këta banues të Kosovës në rrafshin e Dukagjinit kishin filluar dallimet e para, I.S deklaroi se *“edhe në fabrik ku punonin romët rrinin më shumë me serbet kurse na magjup me shqiptarët”*. Në këtë rast kur është pyetur i intervistuaru se si ai e ndien veten sot ai tha *“po neve tash po na thojnë Egjiptian, Egjiptian jam”* dhe i njejtë vazhdon me sqarimet si vijon *“knej ka na romëve të sodit ju kemi thanë përpara “Gabel”, a neve Egjiptianve dhe Ashkalive “Magjup”*.

Ndërsa në rajonin e Kosovës jug-lindore një i intervistuar (B.K) thekson se, *“krejt na nja jem, magjup, veq politika na ka nda”*, e në një rast tjetër në një intervistë me të intervistuarën S.S u deklarua se *“Qeta të ashkalive nuk po ma ndertojnë shtëpinë veq pse jemi rom”* dhe i referohej një politikani të zonës që kishte pozicion politik, por zona ishte e njohur me përbërje mbi 95% Ashkali.

Kur jemi tek situata e luftës dhe ngjarjet përcjellëse tek të gjithë të intervistuarit nga radhët e minoriteteve deklarojnë që pasiguria për jetesë dimjitoze, ndrrimi i sistemit dhe frika e përgjithshme ndikuan që ata t'ikin nga shtëpitë e tyre, disa nga fshati në qytet, disa nga qyteti në qytetin tjetër e disa dhe për në Serbi, Maqedoni dhe Mal të zi. F.B deklaroi se *“na me familje kem ik në fillim të luftës kur tanket hyrën në qytet”*.

3.2. Situat në Kosovë pas vitit 1999 dhe sfidat e integritit social

Personat e zhvendosur nëpër qytet e mdrishme të Kosovës apo e njohur si *“zhvendosje brenda vendit”* sfidat, vështirësit dhe situatat sociale i paraqesin të njëjta. Varfëria, papunësia dhe strehimi janë emëruesit e përbashkët të tyre. Shumica prej tyre kanë jetuar tek të afërmit apo me qera në vitet e para dhe më vonë u janë ndërtuar shtëpi nga fondacione, organizata të huaja, por dhe me buxhet të shtetit të Kosovës.

Problematika e këtyre shtëpive apo lagjeve është se janë ndërtuar në vendet të caktuara shembull lagjja e romëve në fshatin Plemetin (Komuna Obiliq), Roma mahalla (Komuna Gracanicë), Roma mahalla (Komuna Mitrovicë e jugut) dhe lagjet e Egjiptianëve, Ashkalinjëve Koloni (Komuna Gjakovë), Dubravë (Komuna Ferizaj) dhe të tjera. Si rezultat i kësaj në këto lagje janë të stigmatizuara, mungon qasja institucionale dhe për vet banorët ndikon që zhvillimi apo mos zhvillimi i tyre të jetë kolektiv, B.R banor i lagjes Koloni tregon se *“unë dëshiroj që fëmijët e mi të shkojnë në shkollë, na me gruan i bëjmë gati dhe i përcjellim, por fëmijët nuk shkojnë në shkollë, ata bashkohen me bashkëmoshataret e tyre në deponinë e mbeturinave dhe mbledhin kanaqe”* Kjo lagje e ka dhe një problematik më të vecant sepse është e ndërtuar në oborrin e deponisë së qytetit apo thënë ndryshe vendi ku hudhen mbeturinat e tërë qytetit të Gjakovës është rreth 50 metra nga shtëpitë e tyre.

Ndërsa personat e kthyer nga vendet si Serbia, Mali i zi apo Maqedonia e Veriut, sepse ata që janë zhvendosur në vendet e BE-së nuk janë kthyer për të jetuar në Kosovë por vetëm kanë investuar në shtëpi të reja dhe vijnë në kohën e pushimeve verore për të qëndruar një apo dy javë. Shembull personat e kthyer nga Mali i zi në qytete si Peja dhe Gjakova tregojnë se për të jetuar këtu e kanë

më mirë sa i përket kushteve të banimit, A.SH nga Peja deklaroi se *“atje ku kemi jetuar në lagjen Konik (Podgoricë) kemi jetuar një kohë në tenda dhe më pas në baraka (shtëpi nga druri), kurse në Kosovë tani kemi shtëpinë tonë me të gjitha kushtet”*. Por kur jemi tek punësimi A.SH, B.R dhe F.K nga Peja, Gjakova deklarojnë *“në Mal të zi një ditë pune në bujqësi po ndërtime paguhej nga 20 deri në 30 euro, kurse në Kosovë paguhet nga 10 deri në 15 euro”*, i intervistuari I.S gjithashtu deklaroi se *“kur kem qen në mal të zi shkoja dhe punoja në qytetet turistike si Ulqini dhe Budva, atje paguhesha mirë, e prej se jam kthyer në Kosovë u bënë rreth 5 vite, asnjëherë nuk kam punuar; jo që nuk kam dashur por nuk kam gjetur punë”* i pyetur se si jeton ai pa punë, ai tregoi se *“ne jetojmë me asistencë sociale mujore në shumë 130 euro dhe ndonjëherë na ndihmojnë të afërmit nga Gjermania”*.

N.N nga qyteti i Rahovecit tregoi se *“në vitin 1999 kemi shkuar së bashku me vëllaun në Beograd se na kanë thënë po dhashin shpirt për refugjatët, stje kemi qëndruar deri në vitin 2001 në kushte të vështira nëpër baraka, kur jemi kthyer në Kosovë shtëpi nuk kam pasur sepse vllau tjetër e kishte zënë, kam jetuar rreth 5 vite me qera deri sa ma kanë ndërtu këtë shtëpi”* i pyetur se cilat janë sfidat e tijë tani ai tregoi se *“punë nuk ka, mendoj djali si të më rritet edhe pak me qu në grubet, po edhe unë vet edhe pse i kam bërë gati 50 vjet me mujt sot isha ik për në europë”*.

S.S nga qyteti i Ferizajt tregoi se pas kthimit nga Maqedonia tani ka rreth dy vite që jeton me qera, askush nuk është interesuar që të i gjeje zgjidhje banimi, *“kam qenë disa herë në komunë me kanë thënë që duhet të kesh pronë që të të fusim në listën për ndërtim shtëpie”*. Përveç kushteve të përgjithshme sociale dhe problemi i pronave është sfidues sepse shumica e personave të rikthyer nuk kanë pronë, ndërsa ligji e parasheh që duhet të kesh pronë në mënyrë që komuna apo institucionet qendrore të bëjnë ndërtimin e shtëpive.

Në vitin 1936 kur (Steinbeck, 1936) publikoi artikullin *“The Harvest Gypsies”* (në shqip Ciganët e Korrjes) ai deri po krahasonte jetesën e këtyre punëtorëve në kampet e tyre, theksoi që *“Dinjiteti është zhdukur dhe shpirti është kthyer në zemërim të zymtë para se të vdesë”*. Ai deri sa bënte

krahasime e pershkruan situatën si “*ishin hedhur poshtë në një lloj nënnjerëzie*” edhe integrimi social i këtyre komuniteteve menjëher pas vitit 1999 ishte po ashtu i ngajshëm, ata nuk thirreshin që të punonin punë fizike me lehtësi sikur para viti 1999, qytetarët shqiptar hezitnin t’i mirrin në punët kryesisht të bujqësisë.

Kjo për faktin që nga paragjykimi kolektiv dhe mendimi negativ që u krijua gjatë periudhës së luftës dinjiteti i këtyre komuniteteve ishte lënduar dhe ishte e vështirë të kishte pranim apo afërsi në vitete e para pas vitit 1999.

Edhe në raportin e vitit 2005 “Romët dhe Egjiptianët në Shqipëri Nga: Përjashtimi Social në Përfshirjen Sociale” nga Banka Botërore theksohet që për Romët dhe Egjiptianët në vitet e fundit janë zhvilluar situata apo raporte jo të mira në mes tyre dhe popullësisë shumicë të vendeve në europën lindore dhe ballkanin. Në aspektin ekonomik pas prishjes së ndërmarrjeve kolektivizte të komunizmit këto pakica mbetën rrugëve dhe në varfëri të skajshme në vendet si Rumania, Bullgaria e Shqipëria. (World Bank, 2005)

3.3. Sfidat, vështirësitë dhe beneficionet e të qenurit Romë, Ashkali dhe Egjiptian në Republikën e Kosovës

Sipas zyrtarëve komunal për kthim dhe komunitete kjo kategori i gëzon të gjitha të drejtat që derivojnë nga Kushtetuta dhe aktet tjera ligjore.

Dokumentet me të cilat punojnë këto zyre (veç tjerash) janë:

1. *LIGJI NR. 03/L-047 Për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës.* (Kuvendi i Republikës së Kosovës, 2008)
2. *LIGJI NR. 03/L-068 Për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës.* Kuvendi i Republikës së Kosovës. (2008)
3. *LIGJI NR. 02/L-37 Për Përdorimin e Gjuhëve.* Kuvendi i Republikës së Kosovës. (2007)
4. *LIGJI NR. 03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale.* Kuvendi i Republikës së Kosovës. (2008)
5. *LIGJI NR. 02/L-88 Për Trashëgiminë Kulturore.* Kuvendi i Republikës së Kosovës. (2008)

6. LIGJI NR. 03/L-039 Për Zonat e Veçanta të Mbrojtura. Kuvendi i Republikës së Kosovës. (2008)
7. Strategjia për Komunitetet dhe Kthim 2014 – 2018. (Qeveria e Kosovës, 2014)
8. Strategjia Kombëtare për Riintegrim të qëndrueshëm të Personave të Riatdhesuar në Kosovë 2018-2022. (Qeveria e Kosovës, 2018)
9. Strategjia për integrimin e komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptianë në Republikën e Kosovës 2009- 2015. (Qeveria e Kosovës, 2008)
10. Strategjia për Përfshirjen e Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Shoqërinë Kosovare 2017-2021. (Qeveria e Kosovës, 2017)
11. Rregullore (QRK) Nr. 22/2020 Për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar. (Qeveria e Kosovës, 2020)
12. Rregullore (QRK) - NR. 01/2018 Për Kthimin e Personave të Zhvendosur dhe Zgjidhje të Qëndrueshme. (Qeveria e Kosovës, 2018)
13. Plani Komunal të veprimit për kthimin e të zhvendosurve dhe zgjidhje të qëndrueshme 2019 - 2022. (Komuna Shtërrpcë, 2019)
14. Pako Standarde e Riintegrimin të Qëndrueshëm të Personave të Riatdhesuar në Kosovë. (Ministria e Punëve të Brendshme, 2019)

Edhe në strategjinë e parë 2009- 2015 dhe në të dytën 2017-2021 rol të rëndësishëm i është dhënë sektorëve si:

Punësimi dhe Fuqizimi Ekonomi,
 Shëndeti dhe Çështjet Sociale,
 Strehimi dhe Vendbanimet Joformale,
 Regjistrimi dhe Dokumentacioni,
 Çështjet Gjinore,
 Kultura, Mediat dhe Informimi,
 Pjesëmarrja dhe Përfaqësimi Politik.

Të gjitha këto kategori mbeten ende sfida dhe vështirësi në integrimin e komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptian në Republikën e Kosovës, si pasojë e nivelit të ulët të edukimit apo mos përgaditjes profesionale për t'a ushtruar një profesion apo punë të caktuar. A.A zyrtar komunal për komunitete tregon se si sfida për punësim dhe integrim social të komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptian në komunën e tij janë *“mungesa e vendeve të reja të punës dhe mos përgaditja profesionale për profesionet deficietare sepse shpesh kërkohen punëtorë por nuk ka të kualifikuar për shembull në mobileri”* edhe zyrtarja nga komuna tjetër e thekson se mos përgaditja profesionale është hendikep në punësim të qëndrueshëm dhe integrim në punë *“shkollimi dhe rrjedhimisht përgaditja profesionale ka ndikuar që personat e rikthyer të mos mund të gjejnë punë, ne si institucione i kemi mbështetur me banim 1 vjeçar në raste kur nuk kanë pasur shtëpi dhe me grante për vetpunësim në shumë deri 3 mijë euro”*.

Në kronikën e Albana Isufi, publikuar në dhjetor 2005 lidhur me termin *“Diskriminim pozitiv”* i cili kishte filluar moti kohë të përdoret për rastet kur komunitetve pakicë u janë dhënë beneficione si kriteri më i ulët, vende/pozita të rezervuara apo dhe konkurse specifike ku është theksuar që aplikuesit duhet të jenë nga komunitetet pakicë. Juristë dhe deputet të kohës theksonin nevojë që me Shpalljen e Pavarsisë së Kosovës këto beneficione duhe të ndaloheshin dhe të sigurohej barazi e drejtësi për të gjithë. (Evropa e lirë, 2005)

Sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Neni 148 ‘Dispozitat Transicionale për Kuvendin e Kosovës’, pika thekson që për dy mandatet e para zgjedhore, Kuvendi i Republikës së Kosovës do të ketë njëzet vende të rezervuara për përfaqësim të komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë:

1. Dhjetë (10) vende do t’u ndahen partive, koalicioneve, nismave qytetare dhe kandidatëve të pavarur, që janë deklaruar se përfaqësojnë komunitetin Serb të Kosovës,
2. Dhjetë (10) vende do t’u ndahen komuniteteve të tjera si vijon:
 - a) Komunitetit Rom një (1) vend;
 - b) Komunitetit Ashkali një (1) vend;
 - c) Komunitetit Egjiptian një (1) vend;

- d) Dhe një (1) vend shtesë do t'i jepet komunitetit Rom, Ashkali ose Egjiptian, i cili ka numrin më të madh të votave të përgjithshme;
- e) Komunitetit Boshnjak tri (3) vende;
- f) Komunitetit Turk dy (2) vende;
- g) Komuniteti Goran një (1) vend.

Gjithashtu parshihet që “Çdo vend i fituar përmes zgjedhjeve, do të jetë vend shtesë, përveç dhjetë (10) vendeve të rezervuara...”. (Kuvendi i Republikës së Kosovës, 2008)

Neni 144 ‘Amendamenti’, pika 2 “Çdo ndryshim do të kërkojë miratimin e dy të tretave (2/3) të të gjithë deputetëve të Kuvendit, përfshirë dy të tretat (2/3) e të gjithë deputetëve të Kuvendit që mbajnë vende të rezervuara ose të garantuara për përfaqësuesit e komuniteteve që nuk janë shumicë në Republikën e Kosovës”. Po ashtu edhe për emërimet në gjyqësor, Neni 108 ‘Këshilli Gjyqësor i Kosovës’, pika 6 “Këshilli Gjyqësor i Kosovës përbëhet nga trembëdhjetë (13) anëtarë” prej tyre “3) Dy (2) anëtarë i zgjedhin deputetët e Kuvendit, të cilët i mbajnë vendet e rezervuara ose të garantuara për përfaqësuesit e komunitetit Serb në Kosovë, dhe të paktën njëri prej këtyre të dyve, duhet të jetë gjyqtar” dhe “(4) Dy (2) anëtarë i zgjedhin deputetët e Kuvendit, të cilët mbajnë vendet e rezervuara ose të garantuara për përfaqësuesit e komuniteteve të tjera, dhe të paktën njëri prej këtyre të dyve, duhet të jetë gjyqtar”. (Kuvendi i Republikës së Kosovës, 2008)

Neni më problematik edhe nga ekspertët e fushës juridike është thënë që “minon sovranitetin e republikës” është Neni 81 ‘Legjislacioni me Interes Vital’, ku pika 1 thotë “kërkohet vota e shumicës së deputetëve të Kuvendit të cilët janë të pranishëm dhe që votojnë, si dhe të shumicës së deputetëve të cilët mbajnë vende të rezervuara ose të garantuara për përfaqësuesit e Komuniteteve që nuk janë shumicë”. Pra kërkohen dhe votat shumicë të minoriteteve pakicë për ndryshime kushtetuese si:

(1) ligjet të cilat ndryshojnë kufijtë e komunave, themelojnë ose shuajnë komuna, përkufizojnë shtrirjen e pushteteve të komunave dhe pjesëmarrjen e tyre në marrëdhëniet ndërkomunale dhe tejkufitare;

- (2) ligjet të cilat zbatojnë të drejtat e komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre, me përjashtim të atyre të përcaktuara me Kushtetutë;
 - (3) ligjet për përdorimin e gjuhëve;
 - (4) ligjet për zgjedhjet lokale;
 - (5) ligjet për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore;
 - (6) ligjet për liritë fetare ose për marrëveshjet me komunitetet fetare;
 - (7) ligjet për arsimin;
 - (8) ligjet për përdorimin e simboleve, përfshirë simbolet e komuniteteve dhe për festat publike.
- Problematike gjithashtu është dhe pika 2 e këtij neni e cila potencon që *“Asnjëri nga ligjet me interes vital, nuk mund t’i nënshtrohet referendumit”*.

Marrë parasysh strukturën aktuale të partive politike minoritare ku në kampin serb kemi vetëm një parti dominuese “Lista Serbe” e cila përveç 10 vendeve që merr në vendet e garantuara për serbet, ashtu siç dhe është dëshmuar më lart ajo synon që nëpërmjet marrëveshjeve apo planifikimeve politike, që në rastin e zgjedhjeve të fundit u dëshmuar që ishin dhe jo ligjore të arrijë të marr deputet dhe nga grupi i 10 deputetëve të pakicave të tjera. Shembull deputetin goran Adem Hodža nga Partia Unike Gorane pas marrjes së mandatit të deputetit bashkohet me grupin parlamentar lista serbe, e njejta ishte planifikuar që të ndodhte dhe me deputetin tjetër Fadil Gashi nga partia Romani Iniciativa (RI), por i cili pas reagimit të institucioneve dhe marrjes së një mandati nga Paneli Zgjedhor për ankesa dhe parashtesa kësaj partie, ka vendosur të qëndroj si deputet i pavarur. (Evropaelire, 2021)

Duhet thënë që deputeti Adem Hodža ishte karta e fundit për zgjedhjen e qeverive, e Presidentes së fundit dhe shumë procese të rëndësishme në Kuvendin e Kosovës, kështu duke marrë shumë përfitime, e pozita publike ndër vite. (BlicMedia, 2021)

Marrë parasysh dhe praktikën lokale të funksionimit të partive serbe dhe të komuniteteve, shembull një deputet në kampin e partive jo serbe mund të zgjidhet me më pak se një mijë vota, apo një parti

me rreth dy mijë vota siguron një deputet (varet dhe nga dalja në zgjedhje sigurisht). Kemi të bëjmë me grupe të cenueshme në kuptim lehtë të manipulueshme sikur në rastin e Romani Iniciativa dhe Ujedinjena Zajednica – Adrijana Hodzic - UZ-AH të cilat morrën mbi 4 mijë vota rrespektivisht mbi 2 mijë dhe kishin siguruar nga 2 deputetë në kampin e partive minoritare jo serbe (boshnjake dhe rome).

Sistemi aktual do të ishte më i përshtatshëm nëse tek partit sebe do të kishte më shumë pruralizëm dhe tek partit e tjera minoritare më shume demokratizim se sa bunkerizim të disa individëve që me dekada kanë qenë deputet apo udhëheqës dhe fare pak kanë ndikuar në përmirësimin e jetës sociale të komunitetit që përfaqësojnë. Sistemi aktual u mundëson grupeve, individëve të integrohen lehtë në politikë dhe të marrin pozita udhëheqëse por në integrimin shoqëror të qytetarëve të këtyre komuniteteve lenë shumë për të dëshiruar. (Beha, 2017)

Shembull tjetër tek kampi serb është dhe kërcënimi i kandidatëve të partive që serbe por që nuk janë pjesë e “Listës serbe”, në kohë zgjedhjesh jo vetëm këta kandidat por edhe qytetarë e thjeshtë nëpër komunat me shumivë serbe kërcënohen apo shantazhohen. (Ballkani.info, 2019)

3.4. Çka ofron Republika e Kosovës për këto grupe minoritare dhe pritshmëritë e tyre

Në të gjitha intervistat e realizuara me personat e zhvendosur brenda vendit, si në rajonin e Kosovës (jug-lindje) ashtu dhe në Dukagjin (jug-perëndim) nevojat e ngjajshme dhe ndër të parat ishin ajo për punësim, kujdes shëndetësorë, ndërsa më pak por e theksuar dhe për arsim e vetëpunësim. Në të gjitha rastet problemet sociale ishin të ngjajshme dhe me ato të shumicës së banorëve të Kosovës që janë derivat i zhillimit të vogël ekonomik dhe papunësisë.

Sipas legjislacionit në fuqi dhe dokumneteve strategjike, anëtarëve të këtyre minoriteteve u garantohen të gjitha lirit themelore dhe të drejtat e barabarta me të gjithë qytetarët e Kosovës. Marrë parasysh strukturën e minoriteteve në Kosovë, institucionet qendrore janë më shumë të kufizuar karshi komunitetit serb se sa pakicave të tjera. Vet Ministria për Komunitete dhe Kthim e

cila udhëhiqet nga serbë tradicionalisht, investon miliona euro të shtetit të Kosovës për të ndërtuar shtëpitë serbve, dhe në rastet kur ata nuk kthehen apo i shesin shtëpitë, kurse për komunitetet tjera përqindja e investimeve është simbolike. (Koha, 2019)

KONKLUSIONE

Në Kosovë përveç Shqiptarëve jetojnë dhe pakicat tjera apo grupet minoritare të cilat më shumë njihen si komunitete. Serbët, Turqit, Boshnjakët, Romët, Ashkalinjët, Egjiptianët janë grupet më të mëdha kurse ka më pak dhe Kroat e Malazez.

Bashkëjetesa dhe harmonia ndër etnike, e fetare ka qenë gjithmonë e përmbajtur, dallimet janë vërejtur në veçanti në mes shqiptarëve dhe serbve. Deri para viteve të 80-ta situata socio politike ka qenë e normalizuar, dallimet dhe divergjencat janë përdorur si vlera kombëtare, të gjitha këto grupe etnike apo kulturore ishin të orgnizuar nëpër klube kulturore e sportive.

Shembull në Ansamblin e Këngëve dhe Valleve “Kastrioti” në qytetin e Ferizajt në këtë periudhë orkestra ishte e përbërë nga shqiptarë dhe romë, vlenë të thkesohet që në këtë kohë me emërtimin “rom” janë identifikuar ata që sot njihen si Romë, Ashkalinjë dhe Egjiptian.

Me vdekjen e udhëheqësit të Jugosllavisë Josip Broz Tito në vitin 1980, në Jugosllavinë e atëhershme filluan të krijohen përçarje politike, divergjenca mendimesh dhe si rezultat u filloj krijimi i polarizimeve socio kulturore. Në Kosovën e viteve 80-ta situata ishte dhe më e vështirë se sa në Kroaci apo Maqedoni, sepse të qenurit Krahinë Autonome Serbia filloi menjëher me shtrëngim masash, kishte shume pabarazi sociale, zhvillimi ekomik ishte i ngadalt dhe ato të drejta që u fituan me Kushtetutën e vitit 1974 filluan të cenohen.

